



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 15 prill 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes në lidhje me Dosjen Paraprake të Prokurorisë

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 95(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendim mbi Kategorizimin e Provave Materiale sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me të” (“Vendimi për Kategorizimin”), në të cilin Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, refuzoi kërkesën² e Mbrojtjes së Kadri Veselit (“Mbrojtja e z. Veseli”) për të urdhëruar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që të dorëzojë dosjen paraprake në bazë të nenit 95(4) të Rregullores deri në prill 2021.³
2. Më 24 mars 2021, gjatë konferencës së katërt për ecurinë e çështjes, Mbrojtja e z. Veseli i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të urdhëronte ZPS-në të dorëzonte dosjen paraprake jo më vonë se 1 qershori 2021 (“Kërkesa”).⁴
3. Më 6 prill 2021, ZPS-ja parashtroi përgjigjen e vet ndaj Kërkesës (“Përgjigja”).⁵
4. Më 12 prill 2021, Mbrojtja e z. Veseli parashtroi kundërpërgjigjen e vet (“Kundërpërgjigja”).⁶

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 16 shkurt 2021 (“Transkripti i 16 shkurtit 2021”), f. 267, rreshti 12 deri në f. 268, rreshti 9.

³ KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kategorizimin e Provave sipas Rregullës 109(c) dhe Çështje të lidhura me të*, 12 mars 2021, publik, para. 23.

⁴ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021 (“Transkripti i 24 mars 2021”), publik, f. 392, rreshtat 10-12..

⁵ KSC-BC-2020-06, F00243, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Dosjen Paraprake*, 6 prill 2021, publike.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00244, Mbrojtja e Veselit, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit lidhur me “Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Veselit në lidhje me Dosjen Paraprake”*, 12 prill 2021, publike.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në bazë të rregullës 95(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që të mos ketë vonesa të papërligjura të procedimit dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

6. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar të paraqesë: (i) dosjen paraprake, e cila përfshin çfarëdo pranimi në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes, si edhe një listë të pikave të pakontestuar; (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë, ku përfshihet, kurdoherë që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.

III. DISKUTIM

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin për Kategorizimin ai theksoi se kategorizimi specifik për këtë çështje që do të zbatohet në programin elektronik për nxjerrjen e materialeve *Legal Workflow*, i ofron Mbrojtjes udhëzime të mjaftueshme gjatë leximit të materialit të nxjerrë sipas rregullës 102(1)(b).⁷ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk konstatoi asnjë arsye për të urdhëruar ZPS-në të dorëzojë dosjen paraprake që në prill 2021.⁸

8. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk shprehet në lidhje me afërsinë kohore midis dorëzimit të dosjes paraprake të ZPS-së dhe kalimit të dosjes së çështjes trupit gjykues, aq më tepër duke mbajtur parasysh mbrojtjen e dëshmitarëve.⁹ Përcaktimi i kohës dhe fazës në të cilën palët duhet të dorëzojnë dosjet paraprake dhe materialet e tjera

⁷ Vendimi për Kategorizimin, para. 23.

⁸ Vendimi për Kategorizimin, para. 23.

⁹ Kundërpërgjigjja, para. 2, 8.

përkatëse sipas rregullës 95(4) dhe (5) të Rregullores, lidhet kryesisht me kryerjen e procedurave efikase dhe të drejta, duke mbajtur parasysh ecurinë e procesit të nxjerrjes së materialeve dhe rrjedhimisht nevojën që palët të përgatiten për gjykim. Në këtë moment, Mbrojtja është në gjende të fillojë hetimet e saj, nëse dëshiron, duke marrë parasysh udhëzimet që ofrojnë dokumentet e shumta, provat materiale dhe kategorizimi, të cilat i janë dhënë ose nxjerrë Mbrojtjes.¹⁰ Prandaj, duke marrë parasysh se kategorizimi dhe nxjerrja e materialit sipas rregullës 102(1)(b) pritet të vazhdojë deri më 23 korrik 2021,¹¹ dhe se nxjerrja e materialit sipas rregullës 102(3) me gjasë do të vazhdojë deri në shtator 2021,¹² Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të parakohshme, në këtë fazë, të caktojë një datë për dorëzimin e dosjes paraprake dhe materialeve të tjera përkatëse nga ZPS-ja.

IV. VENDIM

9. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake **REFUZON** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 15 prill 2021
Në Hagë, Holandë

¹⁰ Vendimi për Kategorizimin, para. 14, 23.

¹¹ Vendimi për Kategorizimin, para. 22.

¹² KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me to*, 23 nëntor 2020, publik, para. 99(h); Transkript i 24 marsit 2021, f. 390, rreshti 19 deri në f. 391, rreshti 8.